



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



01nr
Dt:

112102-64178
12.12.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullores për Prokurim Publik/Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nxjerrë:

V E N D I M

1. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës: “Organizimi i festave të fund vitit”, me numër identifikues: 632-25-10139-2-2-1 dhe numër të brendshëm 632-25-122-221;
2. Sipas pikës 1 te këtij vendimi Menaxher i kontratës caktohet Labinot Efendiu - Zyrtar për sport, mob. 049/424- 250, labinot.efendiu@rks-gov.net;
3. Sipas pikës 1 te këtij vendimi, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës caktohet Fisnik Caka, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, mob. 044/635-708, email: fisnik.caka@rks-gov.net;
4. Menaxheri i kontratës, Komisioni për pranimin e furnizimeve dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Nenin 70 të Rregullores për Prokurim Publik/Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 si dhe Doracaku për Menaxhim të Kontratës;
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ
Ardian Gjini



Kopje: Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Drejtorisë së Prokurimit;
Drejtorit të Drejtorisë Përkatëse dhe
Arkivit të Komunës